- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.		1			
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1				

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

PËR MBIKËQYRJEN E PUNIMEVE NË OBJEKTIN:

“Furnizimi me ujë i fshatit Rreth Kale, Njësia Administrative Muhur”

Vlera: 1,347,332 lekë (pa T.V.SH)

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Me fondet nga buxheti i shtetit për vitin 2024 është parashikuar të kryhet shërbimi: **“Supervizion Furnizimi me ujë i fshatit Rreth Kale, Njësia Administrative Muhur”** sipas fondit limit prej **1,347,332 lekë (pa T.V.SH)** me **Kod Projekti: 19AF245**.

Për këtë i kërkohet mbikëqyrësit të punimeve të kësaj kontrate, të kryejë mbikëqyrjen e këtij objekti, me fondin limit të mbikëqyrjes të llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016” *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimit”*. Grupi III tarifor.

Vlera e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e llogaritur mbi bazën e fondit limit të punimeve punimeve (ndërtim-montim) është 1,347,332 lekë (pa T.V.SH) ose 1,616,798 lekë (me T.V.SH).

1. OBJEKTIVI KRYESOR I MBIKËQYRJES SË PUNIMEVE

Mbikëqyrësi i punimeve në zbatimin e punimeve për objektin, ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjek mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve, duke përfshirë monitorimin, inspektimin dhe raportimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes në përputhje me projektin, rregullat teknike të zbatimit, specifikimet teknike si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve të këtij objekti (afatin sipas grafikut të punimeve) dhe anën ekonomike të këtij objekti (vlefta e kontratës të zbatimit punimeve).

Ai mbikëqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.

2. DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E MBIKËQYRËSIT TË PUNIMEVE

2.1 Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikëqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

2.1.1 Të mbikëqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Shoqërisë Rajonale UK Dibër dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas kontratës së nënshkruar dhe sipas Ligjit Nr

8402, datë. 10.09.1998, U.K.M Nr. 1 datë. 22.02.2005, U.K.M Nr 2 datë.13.5.2005, Vendimin Nr.610 datë 22.09.2022 dhe të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim.

Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standarteve të përcaktuara me ligj.

2.1.2 Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë te zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi.

2.1.3 Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor stafin e tij Mbikëqyrës, siç është përcaktuar në kërkesat e stafit kryesor.

2.2 Të paraqesë pranë Shoqërisë Rajonale UK Dibër *stafin e tij mbikëqyrës* në përbërje të së cilit duhet të ketë:

Drejtuesin e punimeve dhe Mbikëqyrësin e materialeve dhe cilësisë që duhet të jetë **inxhinier Hidroteknik** ose **Ndërtimi** me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas rregullave teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikaten e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek dhe miraton cilësinë e produkteve, korrespondencën me Shoqëria Rajonale UK Dibër miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.2.1 Inxhinieri për punimet topografike që duhet të jetë inxhinier topograf me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton piketimet dhe kuotëzimin e objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.2.2 Inxhinieri për punimet ndërtimore që duhet të jetë inxhinier ndërtimi me liçencë profesionale, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit;

2.2.3 Inxhinieri për punimet hidroteknike që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

Shënim: Në bazë të volumit të punimeve dhe vleftës së kontratës drejtuesi i punimeve duhet të jetë rezident në objekt dhe stafi tjetër mbikëqyrës mund të jetë rezident çdo ditë në objekt ose me kohë të pjesëshme.

2.2 Mbikëqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktin me Shoqërinë Rajonale UK Dibër, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin dhe probleme të ndryshme që mund të lindin gjatë zbatimit.

2.3 Mbikëqyrësi vihet në dijeni nga Shoqëria Rajonale UK Dibër për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontratën e nënshkruar.

2.4 Mbikëqyrësi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet qeverisëse lokale ose qëndrore në juridiksionin e të cilit ndodhet zona e ndërtimit ku kryhen punimet e këtij objekti dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me nenin 9, të Ligjit Nr 8402, dt.10.09.1998.

3. DETYRAT E MBIKËQYRËSIT

3.1 Mbikëqyrësi ka për detyrë:

3.1.1 Të bëj verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të liçensave të autorizimeve dhe të lejeve që sipas dispozitave në fuqi duhen të merren para fillimit të punimeve.

3.1.2 Të bëj verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.

3.1.3 Të njihet me hollësi me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundëshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.

3.1.4 Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit me të dhënat e mëposhtme:

Emërtimi i objektit.....;

Data e marrjes së lejes së ndërtimit

Investitori:

Projektuesi

Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik..... sh.p.k;

Mbikëqyrësi punimevesh.p.k;

Afati i ndërtimit të objektit.....;

Vlera e objektit.....Lekë (me TVSH);

3.2 Mbikëqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

3.2.1 Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese, të sigurisë, shiritave, fenerëve etj, sipas dokumentacionit të vlerësimit të rrezikut, (Vendimi, nr 312, dt .05.05.2010 i Këshillit të

Ministrave "*Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe koordinimit*) (PSK).

3.2.2 Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë "*Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve Dibër Sh.a*" të gjithë dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:

- Stafi i sipërmarrësit;
- Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit;
- Laboratori i licensuar që do të kryhej testet e materialeve;
- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar;
- Të kontrolloj zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt- zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka, ti propozojë Shoqërisë Rajonale UK Dibër zgjidhjet konkrete;
- Të ndjek në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta duke dhënë udhëzime, porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse të kontratave;
- Të kërkojë të zbatojë në mënyrë korrekte plan - organizimin e punimeve të objektit;
- Të kërkojë dhe të zbatojë lejen (autorizimin, pëlqimin) mjedisore të miratuara nga organi kompetent;
- Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme pikëtimin e objektit, kuotat e thellësisë së kanaleve dhe kuotat e vendosjes së veprave të artit;
- Të respektoj dokumentacionin përkatës kur objekti ndërtohet në zonat turistike, arkeologjike apo të trashëgimisë kulturore;
- Të kontrollojë bazamentin e objektit dhe të japë miratimin e tij për vazhdim të punimeve;
- Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër dhe mënyrën e vendosjes së tij dhe standartet e cilësisë së materialeve;
- Për çdo punim të dukshëm ose të padukshëm në të gjitha fazat e ndërtimit të bëjë fotografimin ose regjistrimin e tij dhe të mbaj proces-verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit;
(*Formati tip sipas vendimi Nr.610 datë 22.09.2022 sipas shtojces 7 dhe 8*)
- Në fund të çdo dite pune të kontrolloj ditarin e punimeve dhe të firmos atë;
(*Formati tip sipas vendimi Nr.610 datë 22.09.2022 sipas shtojcës 5*)
- Të kontrollojë situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në fazat e ndryshme të punimeve dhe miratojë ato;
(*Formati tip sipas vendimi Nr.610 datë 22.09.2022 sipas shtojcës 12*)
- Të kontrollojë librezën e masave ku pasqyrohen vëllimet metrike, gradualisht me zhvillimet e tyre;
(*Formati tip sipas vendimi Nr.610 datë 22.09.2022 sipas shtojcës 4*)
- Të kontrollojë certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen e tyre në objekt;
- Të njoftojë sipërmarrësin për difektet e vëna re dhe kohën e korigjimit të tyre; Punimet me difekte nuk pranohen dhe nuk financohen deri në korigjimin e tyre.
- Gjatë zbatimit të projektit i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit aq herë që e sheh të nevojshme dhe sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me

shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë nga mbikëqyrësi i punimeve;

- Për çdo rast që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projekt-Preventivin e parashikuar, mbikëqyrësi i punimeve duhet të paraqesë pranë Shoqëria Rajonale UK Dibër, një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi i miratuar edhe nga projektuesi dhe më pas ky ndryshim do të zbatohet në objekt vetëm pas miratimit nga Shoqëria Rajonale UK Dibër;
- Të nënshkruajë aktin përfundimtar të kontrollit të punimeve për faza të ndryshme;
- Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë Shoqëria Rajonale UK Dibër raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve, pagesave të kryera, realizimine punimeve në vleftë dhe %, afatin kohor të realizimit të financimit;

Raporti mujor do të ketë këtë përmbajtje:

- Hyrje
- Informacion i përgjithshëm
 - Të përgjithshme;
 - Qëllimi i punimeve;
 - Mbikëqyrja e punimeve ndërtimore;
- Personeli i siguruar nga Mbikëqyrësi
 - Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve;
 - Stafi aktual;
 - Kohëqëndrimi në objekt për secilin;
- Raportimi
- Kohëzgjatje e shërbimit të Mbikëqyrjes
- Përshkrimi i projektit sipas nënobjekteve përkatëse
 - Burimet ose pushtimet
 - Depot
 - Linjat e Ujësjiellit, (rrjet kryesor, rrjet sekondar, tercial), etj:
- Organizimi i Sipërmarrësit
 - Sipërmarrësi;
 - Stafi prezent;
 - Mjete dhe makineri;
 - Kohëqëndrimi në Objekt;
- Progresi mujor
- Përshkrim të punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave)
- Fotografi të proceseve të punëve të kryera
- Fotografi të punimeve kryesore të dukshme ose të padukshme.
- Grafiku i ecurisë së punimeve
 - Të aprovuara
 - Të kryera
- Volumet progresive të punimeve mujore
 - Punimet e aprovuara
 - Çertifikatat e cilësisë dhe testet laboratorike
 - Libreza e masave
 - Punimet e kryera por të pa aprovuara
 - Situacionet mujore
 - Matjet topografike

-
- Korespodenca
 - Proces - verbale
 - Urdhëresa, Udhëzime, Njoftime;
 - Ndryshime në Projekt dhe Preventiv nëse ka (të aprovuara nga Shoqëria Rajonale Uk Dibër);
 - Moti (kalendarik)
 - Problemet që kanë dalë
 - Teknike
 - Sociale
 - Konkluzione

Shënim: Raporti mujor dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pesë kopje dhe tre kopje, të dorëzohen në Shoqërisë Rajonale UK Dibër, pranë *Drejtorisë Teknike*.

Raporti mujor do t'i dorëzohet Shoqërisë Rajonale UK Dibër brënda datës të caktuar në kontratë.

Konsulenti do të mbajë kontakte të vazhdueshme me Shoqërisë Rajonale UK Dibër, *Drejtorisë Teknike* dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.

4. PËRGJEGJËSITË E MBIKËQYRËSIT

4.1 Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit (sipas ligjit Nr.120, datë 07.10.2020, Neni 7.1, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8402, dt 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar.)

4.2 Me fillimin e punimeve mbikëqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin objektit si më poshtë vijon:

1. Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori sëbashku me specifikimet teknike;
2. Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet;
3. Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike;
4. Saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit;
5. Për realizimin pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe Shoqërisë Rajonale UK Dibër, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit;
6. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit. Sipërmarrësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij;
7. E gjithë korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me investitorin dhe me sipërmarrësin përbën dokumentacionin e plotë të objektit dhe si e tillë ruhet me çdo kusht ku pasqyrohen të gjitha aktet, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontraditat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme.

-
8. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve të mbahet proces-verbali i dorëzimit të punimeve, ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri.
 9. Shoqëria Rajonale Uk Dibër kontrollon praninë e mbikëqyrësit të punimeve në objekt dhe në rast konstatimi të mungesës së tij nxjerr vendim për pezullimin e punimeve deri në emërimin dhe praninë e tij në objekt;

5. TË DREJTAT E MBIKËQYRËSIT

5.1 Mbikëqyrësi ka të drejtë:

- 5.1.1** Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë në punë;
- 5.1.2** Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor, n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar;
- 5.1.3** Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun;
- 5.1.4** Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësojë ato me materiale të tjera nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij;
- 5.1.5** Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve;
- 5.1.6** Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit;
- 5.1.7** Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër, dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurt dhe cilësore;
- 5.1.8** Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike;
- 5.1.9** Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi këto duhet të dokumentohen me proces-verbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit;
- 5.1.10** Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit;
- 5.1.11** Të kërkojë kryerjen e provave me ngarkesë ose pa ngarkesë sipas Standarteve Shqipëtare të miratuara nga Drejtoria Përgjithshme e Standartizimeve, K.T.P apo K.T.Z në fuqi për tubacionet e vendosura në objekt;
- 5.1.12** Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka dëmtime të rënda, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.

-
- 5.1.13** Mbikëqyrësi i punimeve urdhëron sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në projekt-zbatimin ose Specifikimet Teknike.
- 5.1.14** Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet për ekzekutim teknik të gabuar ose paafësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e Shoqërisë Rajonale UK Dibër për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas fajit, mbikëqyrësi së bashku me Shoqërinë Rajonale UK Dibër dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit të punimeve dhe të ndryshimit të shpenzimeve.
- 5.1.15** Mbikëqyrësi duhet të firmosë gjithë dokumentacionin që ka miratuar, ai mban përgjegjësi ligjore së bashku me sipërmarrësin. Një kopje e dokumentacionit të miratuar nga mbikëqyrësi i dorëzohet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit të objektit.
- 5.1.16** Mbikëqyrësi merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës si dhe firmos proces-verbalin e kolaudimit;
- 5.1.17** Mbikëqyrësi kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht Shoqërisë Rajonale UK Dibër për gjëndjen e tij, në rast se Shoqëria Rajonale UK Dibër ka vërejtje e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet midis tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

5.2 Në përfundim të punimeve Mbikëqyrësi:

5.2.1 Mbikëqyrësi me kërkesë të sipërmarrësit vërteton në proces-verbal datën e përfundimit të punimeve sipas projektit, kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara në kushtet e kontratës dhe brënda 30 ditëve merr prej tij dokumentacionin përkatës.

5.2.2 Duke u mbështetur në Ligjin 8402, datë, 10.09.1998, U.K.M Nr 2, datë. 13.5.2005 dhe U.K.M Nr.3. datë.15.02.2001 i ndryshuar me udhëzrinn, Nr 1, datë 16.06.2011, vendimi Nr 610 datë 22.09.2022, dorëzon pranë Shoqëria Rajonale Uk Dibër (Sektorin e Monitotimit të Zbatimit të Projekteve) të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin saktësinë dhe vërtetësinë e tij.

Dokumentacioni duhet të përmbajë:

1. Proçes -verbalin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit;
2. Proçes-verbalin për fillimin e punimeve;
3. Kontratën e sipërmarrësit;
4. Kontratën e mbikëqyrjes së punimeve;
5. Projekt organizimin e punimeve;
6. Projekt – Zbatimin, të miratuara nga organi, I cili k ate drejte sipas juridiksionit dhe oponencës teknike
7. Projekt - Zbatimin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korrespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme;
8. Preventivin e plote te projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjithë volume e punimeve, të hartuara nga projektuesi
9. Preventivin e ndryshuar (nëse ka zëra të rinj të punimeve, negociimin e tyre)

-
10. Planorganizimit të punimeve të ndërtimit, I cili përmban planin e ngritjes dhe organizimit të kantierit, grafikut e përgjithshëm të punimeve dhe planin e veprimit për ndërtimit të objektit sipas projektit, në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës. Grafiku i punimeve;
 11. Specifikimet teknike;
 12. Azhurnimi para fillimit të punimeve dhe pikëtimi i objektit;
 13. Dokumentacioni topografik dhe gjeologo-inxhinierik;
 14. Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi për punimet e dukshme dhe të padukshme;
 15. Proçes-verbale të çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi i punimeve të shoqëruar me fotografitë përkatëse;
 16. Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi;
 17. Libreza e masave;
 18. Shkresën e mbikëqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezervë shoqëruar me dokumentacionin përkatës:
 - Proçes - verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga (Sipërmarrësi, drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi i punimeve;
 - Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi i punimeve;
 - Situacioni i fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi i punimeve.
 19. Çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe testet laboratorike të materialeve të përdorur në objekt;
 20. Miratimi i materialeve të përdorura nga mbikëqyrësi i punimeve;
 21. Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar;
 22. Regjistri i kontabilitetit të shpenzimeve;
 23. Deklarata teknike e sipërmarrësit e firmosur nga sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik;
 24. Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve;
 25. Dokumentin e vlerësimit të rrezikut sipas Vendimit Nr.312 datë. 05.05.2010 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe Koordinimit (PSK);
 26. Proçes- verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi sëbashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar;
 27. Relacionin përfundimtar i mbikëqyrësit të punimeve;

(Formatet tip të dokumentacionit të jenë sipas formatit tip, sipas vendimi Nr 610 datë 22.09.2022)

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e mbikëqyrësit të punimeve.

Dokumentacion është në 3(tre) kopje, një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë kolaudatorit ose grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër të Shoqërisë Rajonale UK Dibër brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve në objekt.

Të gjitha dokumentat që dorëzohen tek kolaudatori ose në grupin e kolaudimit pranë Shoqërisë Rajonale UK Dibër duhet të jenë origjinale.

- Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet grupit të kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos proçes-verbalin e kolaudimit.

-
- Mbas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe dokumentacionin tjetër përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për likujdim Shoqërisë Rajonale UK Dibër.

6. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES

6.1 Bazuar në “Grafiku i Punimeve”, pjesë e projekt-zbatimit të objektit: “Furnizimi me ujë i fshatit Rreth Kale, Njësia Administrative Muhur”, është parashikuar që zbatimi i punimeve të ndërtimit të zgjasë 6 muaj.

6.1.1 Pa u kushëzuar nga sa më sipër, kohëzgjatja e shërbimit të të mbikqyrjes do të jetë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve, deri në përfundim të objektit.

6.2 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë largimin e Mbikëqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

6.2.1 Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.

6.2.2 Ndërprerje të pa arsyeshme të punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.

6.2.3 Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike;

6.2.4 Kur konstatohen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Shoqëria Rajonale UK Dibër ka të drejtë të urdhëroj mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes.

6.2.4 Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative vendosen sanksione në bazë të neneve 15 dhe 16, të kreut III, të ligjit Nr 8402, datë. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

-
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat ligjore sipas pikës 1 të Shtojcës 8 të D.T.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres së parashikuar të kontratës (vlera e fondit limit)

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikqyrje** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016*”, me kategoritë si më poshtë:

- NP-1 Punime gërmimi në tokë.
- NP-7 Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.

-
- NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit
 - NS-9 Punime strukturore speciale.
 - NS-18 Punime topogjeodezike.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

a) Drejtuesin e punimeve dhe Mbikëqyrësin e materialeve dhe cilësisë që duhet të jetë inxhinier **Hidroteknik ose Ndërtimi** me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikaten e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek dhe miraton cilësinë e produkteve, korrespondencën me AKUK, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt dhe nuk duhet të jetë I lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

b) Inxhinieri për punimet topografike që duhet të jetë inxhinier topograf me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton piketimet dhe kuotëzimin e objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

c) Inxhinieri për punimet ndërtimore që duhet të jetë inxhinier ndërtimi me liçence profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

d) Inxhinieri për punimet hidroteknike që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

e) Inxhinieri për punimet mjedisore që duhet të jetë inxhinier mjedisi me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton venddepozitimet e germimeve, planin e menaxhimit mjedisor, dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik fitues, para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

Për secilin pjestar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë:

Kontratë pune të vlefshme

Diplomë

Librezë pune

CV

Licencat profesionale për mbikqyrje.

*** Në këtë rast stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.**

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore mesatarisht **10 (dhjetë) persona** dhe të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve te fundit duke marrë si reference datën e hapjes së tenderit.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

